



REPUBLIKA E KOSOVËS

| | |
|--|--------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS (REPUBLIC OF KOSOVO) | |
| KOMUNË E VUSHTRRISE (MUNICIPALITY OF VUSHTRRI) | |
| Uk. Nr. / Br. | 32 / 16 |
| Nr. I fq. / Br. sh. | - 23 - |
| Data / Datum | 25. 02. 2016 |



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E I-rë E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISE, MBAJTUR
MË 28 JANAR 2016

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:13.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri:

Adnan Klinaku, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habib Mustafa, Hysni Gërguri, Habibe Gërzhaliu, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rustemi, Selvete Sholla Syzana Syla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit- tha se ka ndodhur që në raste të caktuara kemi lexuar për keqpërdorime, afera korruptive apo edhe ndonjë veprim të pahijshëm dhe në dëm të Komunës apo qytetarëve të bërë nga ana e zyrtarëve komunal, apo edhe ndonjë politikani të zgjedhur me vota të popullit në pozita dhe funksione të ndryshme.

Nuk është për t'u habitur që për çdo gjë që bëjmë, mirë apo keq, të jemi të fokusuar në pendën e gazetarëve, sepse për funksionet që ushtrojmë, së paku ne këtu si delegatë, kemi marrë votën e qytetarëve dhe për të gjitha punët dhe veprimet që i bëjmë, duhet të marrim edhe përgjegjësinë.

Tutje shtoi se na pëlqeu apo jo, gazetarët kanë punën e tyre dhe shkruajnë atë që ata e shohin, qoftë e mirë apo e keqe, varësisht nga punët dhe veprimet e atyre që janë të zgjedhur dhe kanë marrë besimin të punojnë në interes të qytetarëve.

Ditën e martë kam qenë shumë e prekur dhe indinjuar me lajmin për sulmin ndaj gazetarit të portalit "Veriu.info" nga ana e disa personave, e aq më shumë kur u kuptua se sulmi është bërë nga njerëz të veshur me petkun e përfaqësuesit të popullit.

I shprehi keqardhjen time të thellë dhe i dëshiroj shërim sa më të shpejt gazetarit Gazmend Morinës, duke uruar që kjo mos t' i përsëritet më kurrë, as atij e as ndonjë gazetari.

Po ashtu, kërkoj nga ky kuvend që të dal me një qëndrim unanim duke e dënuar këtë akt të shëmtuar dhe qyqar, që siç dihet ka për qëllim frikësimin e gazetarëve dhe mbulimin e krimeve dhe aferave korruptive që kanë bërë dhe janë duke i bërë.

Gjithashtu kërkoj sidomos nga Grupi kuvendar i PDK-së që publikisht të distancohet nga veprimet e turpshme të kolegëve të tyre mitrovicas, pikërisht për faktin se këtë vepër penale të pa pranueshme e kanë bërë në qytetin tonë.

Kërkojë nga organet e drejtësisë që ata që kanë kryer këtë vepër të shëmtuar të gjykohen dhe të marrin dënimin e merituar.

Dhe një gjë të fundit, mund të rrihen gazetarët, mund edhe të vriten ata, por nuk mund ta ndalni fjalën e lirë. E vërteta për të gjitha do të dalë në shesh herët apo vonë.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit –propozoi që pikat e rendit të ditës nga 8 deri tek pika 14 të shqyrtohen bashkërisht pasi këto pika janë të natyrës së njëjtë dhe të njëjtat mundë të votohen në pako.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit –tha se dega e LDK-së reagon ashpër ndaj dhunës që është ushtruar ndaj gazetarit Gazmend Morina, dhe kërkojmë nga organet e rendit që t'i japin dënimin e merituar autorëve të kësaj veprë.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit–në emër të grupit kuvendar të VV-së paraqiti këtë reagim: gazetari i portalit “veriu.info”, dhe punëtori i Komunës së Vushtrrisë Gazmend Morina, u sulmua fizikisht. Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Vushtri e dënon një akt të tillë, akt ky që nuk është i izoluar. Kërkojmë nga organet e rendit që t'i nxjerrin menjëherë para drejtësisë sulmuesit e gazetarit Gazmend Morina, në mënyrë që të ndalen aktet e tilla që cenojnë lirinë e shprehjes, dhe përgjegjësit të marrin dënimet e merituar. Gazetarit i urojmë shërim të shpejtë dhe forcë që ta tejkalojë këtë sfidë.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –shprehu keqardhjen e tij për sulmin ndaj gazetarit Gazmend Morina dhe ceku se ky sulm ka ndodhur jashtë institucionit të komunës, andaj vlerësoi se kuvendi nuk mund të merret me deklarata politike por apeloj që organet e drejtësisë ta bëjnë punën e tyre.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit–paraqiti një përmbledhje lidhur me punën e organeve komunale për vitin e kaluar dhe ceku edhe disa teza të tij lidhur me realizimin e suksesit më të madh në punën e institucionit të komunës për të ardhmen. Tutje shtoi se përkundër shumë projekteve të realizuara në fusha të ndryshme gjendja ekonomike vazhdon akoma të jetë jo e mirë. Pastaj vlerësoi se mungesa e zhvillimit ekonomik po shkakton varfëri tek popullata dhe rritje kronike të numrit të të papunëve edhe për kundër fakti se të ritë tanë janë të kualifikuar ata nuk po mundë të gjejnë një vend të qëndrueshëm të punës. Në këto rrethana konsideron se kuvendi i komunës duhet të gjejë një forcë të bashkëpunimit sa më të ngushtë me të gjitha organet komunale dhe ato qendrore duke inkurajuar përpjekjet për gjetjen e alternativave ekonomike si zgjidhje e domosdoshme e zhvillimit ekonomik dhe për të adresuar çështjen e brengave të qytetarëve. Mandej tha se çështja kryesore që kërkon zgjidhje është zhvillimi ekonomik i komunës e më këtë edhe hapja e vendeve të reja të punës gjetja e mundësive dhe perspektivave për të rinjtë, përcaktimi i obligimeve të planifikimit buxhetor duhet të ndryshohet për aq sa është e mundur ku imperativ i komunës duhet të jetë hartimi i projekteve konkrete që do të ndikonin në zhvillimin ekonomik. Në këtë kontekst shprehu se nuk duhet të kufizohemi vetëm në buxhetin aktual por duke insistuar në kontinuitet realizimin e këtyre projekteve konkrete. Në fund ai masë për ndikim në zhvillim ekonomik apeloj qeverinë komunale gjegjësisht kryetarin e komunës që gjejë modalitete për donacione dhe investime si dhe të filloj procesin e ndërtimit të “*parkut industrial*” që sipas përlllogaritjeve paraprake vetëm në gjashtë mujorin e parë do të hapën 500 vende të reja të punës ndërsa në gjashtë mujorin e dytë ky numër do të dyfishohej.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit –në replikë me kryesuesin e kuvendit ceku se gazetari i sulmuar është edhe punëtor i Komunës, andaj kuvendi duhet të marr një qëndrim lidhur me këtë çështje.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit–tha se lidhur me rastin e sulmit ndaj gazetarit të “veriu.info” kuvendi nuk duhet të jetë indiferent por të marr një qëndrim ai shprehu bindjen e tij se duhet që ky rast të del para organeve dhe të zgjidhet sa më parë. Pastaj, tha se duhet të punohet në

preventiv të këtyre rasteve për të mos ardhur deri tek më e keqja. Kurse lidhur me propozimin që pikat e rendit të ditës nga 8 deri tek pika 14 të bashkohen vlerësoi se këto pika duhet të shqyrtohen veç e veç për faktin se secila nga këto çështje i ka specifikat e veta.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-tha se është shumë e nevojshme që të diskutohet për klubin e futbollit “Vushtrria”, dhe njoftoi se gjendja e klubit nuk është mirë në kuptimin financiar pasi nuk është duke u bërë pagesa e lojtarëve dhe e stafit teknik. Tutje shtoi se nuk është kompetent në kuptimin profesional që jep analizë për gjendjen e klubit dhe vlerësoi se është mirë që për seancën e ardhshme të kërkohet një raport nga ana e klubit për gjendjen e përgjithshme të tij. Kurse lidhur me zërat se ky klub është privatizuar ai njoftoi se nuk është në dijeni për një gjë të tillë dhe se komuna nuk ka informata të tilla por për këtë do të merret raporti nga klubi dhe do të njoftohet edhe kuvendi.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota unanime aprovoi këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.
2. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2015;
3. Shqyrtimi i Planit të Punës së Kryetarit për vitin 2016;
4. Shqyrtimi i Raportit Tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, si dhe realizimin e investimeve kapitale;
5. Shqyrtimi i Planit të Punës së Prokurimit për vitin 2016;
6. Shqyrtimi i Raportit për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollor 2015/2016 dhe përgatitjet për gjysmë vjetorin e dytë;
7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjetjen e eshtrave në fshatin Duboc;
8. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës Trungjet e Shpardhit (*Quercus frainetto*) në Zhilivodë të Vushtrrisë si monument i natyrës;
9. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës Trungjet e Dushkut në Druar të Vushtrrisë si monument i natyrës;
10. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës Trungjet e Dushkut (*Quercus sp*) në Galicë të Vushtrrisë si monument i natyrës;
11. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës Trungu i Bungut (*Quercus petraea*) në Shtitaricë të Vushtrrisë si monument i natyrës;
12. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës Trungu i Rrënjës (*Quercus robur*) në Dumnicën e Llugës të Vushtrrisë si monument i natyrës;
13. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës Burimi Terminal në Gjelbishtë të Vushtrrisë si monument i natyrës;
14. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës Trungu i Qarrit (*Quercus cerris*) në Ceceli të Vushtrrisë si monument i natyrës;
15. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;
16. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore;
17. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për përcaktimin e kritereve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale personave juridik (OJQ) dhe personave fizik (**shqyrtimi i dytë**);
18. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për mbrojtjen e të miturve nga dukuritë që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre (**shqyrtimi i dytë**);
19. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës Kuvendi me vota unanime aprovoi procesverbalin e mbledhjes paraprake të KK-së.

2. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2015.

3. Shqyrtimi i Planit të Punës së Kryetarit për vitin 2016.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit- duke përshëndetur planin e punës për vitin 2016 konsideroi se është një plane gjithëpërfshirës që do të thotë se ne dëshirojmë që ky planifikim të realizohet sipas dinamikës së paraparë. Në kuadër të këtij plani të punës mendoj se kryetari i komunës do të ishte mirë që të ketë një ekip monitorues të formuar në kuadër të kompetencave të tij, me qëllim që edhe kryetari i komunës ne dhe të gjithë qytetarët të kemi në faza periodike një vlerësim se a po realizohet ky plan me të gjitha këto aktivitete. Duke besuar dhe dëshiruar që ky plan i punës të realizohet ashtu siç është planifikuar dëshiroj që në kuadër të tij të diskutoj për disa nga ato aktivitetet që janë planifikuar.

Planifikimi i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, në piken 14 parashihet që të kemi një raport të shpenzimeve dhe informatë lidhur me shpenzimet buxhetore.

Andaj kërkon që në afatet e parapara të informohet edhe pse disa here në këtë kuvend ka kërkuar që të kemi informate të hollësishme për shpenzimet që bëjnë komuna dhe thënë të drejtën deri tash asnjëherë informatë e tilla nuk na është dhënë në dispozicion për të parë shpenzimet të cilat i ka bërë komuna, uroj që këtë vit të kemi një raport të tilla.

Qendra për shërbime të qytetarëve, kërkoj që kjo zyrë të kompletohet dhe të jete më efikase duke krijuar kushte për shtimin e punëtorëve dhe buxhetit me qëllim që kjo zyre të jetë më funksionale se deri me sot

Prokurimi publik, me intereson të dije se a ka filluar komuna përgatitjet për aplikimin e prokurimit online, i cili dihet se me ligjin e ri do të filloj në qershor apo në fillimin e vitit 2017. Mandej në fushën e arsimit, konkretisht pika 8 monitorimi dhe mentorimi i mbarëvajtjes së procesit mësimorë, e që ndoshta është gabim teknik pika 9.1 dhe 9.2 sepse do të duhej të ishte 8.1 dhe 8.2, por si do që të jetë kërkoj që të kemi të plotë informatën për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave dhe rekomandimet eventuale.

Inspeksioni – kërkoj që të shtohet aktiviteti i kontrolleve sidomos tek mallrat të cilave eventualisht ju ka skaduar afati si dhe veprimtarive të ushqimeve sidomos në kohën e verës.

Kultura-mendoj se do të duhej të kishte të planifikuar më shumë aktivitetet kulturo-sportive se sa shënimi i datave të ndryshme të cilat janë të një përmase më të gjere.

Mbrojtja dhe shpëtimi, me intereson të dije se a ka fonde – mjete të mjaftueshme për intervenim në rast të fatkeqësive të ndryshme kolektive dhe individuale dhe është e rëndësishme fushata dhe informimi i popullatës për rreziqet e mundeshe nga fatkeqësitë.

Gjeodezia dhe Kadastër, kërkoj që gjatë këtij viti të kemi një informate të hollësishme për pronën komunale të uzurpuar.

Duke konsideruar se ky plan do të jete lehte i kontrolluar se si po realizohet dhe për mos të qenë vetëm një dëshirë dhe për të shkruar se diçka po punohet uroj që plani i punës për vitin 2016 të jetë i realizuar sepse është interes qytetarëve të komunës sonë.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit –tha se plani i punës së kryetarit për vitin 2016 është fokusuar në identifikimin e çështjeve prioritare caktimin e objektivave të qarta caktimin e prioriteteve indikatorëve dhe afateve kohore për kryerjen e aktiviteteve dhe arritjen e objektivave të caktuara dhe krejt kjo për të iu ofruar shërbime sa ma cilësore qytetarëve, dhe për përmirësimin e jetesës së qytetarëve. Ky plan paraqitet mirë i strukturuar prezanton objektivat e qarta për të gjitha drejtorit komunale përcakton afatet kohore dhe realizimin e objektivave në shumicën e rasteve plani është i matshëm dhe ka koston financiare. Tutje shtoi se tek Drejtoria për

Ekonomi të cilës i është dhënë një prioritet me qëllim të rritjes së punësimit. Pastaj parashtrij pyetje për fondin e ndarë për pemëtari si dhe a kanë bashkëpunim me ekspert përkatës për mostrat e dheut në mënyrë që të caktohen specifikat e kultivimit të pemëve. Pastaj në fushën e arsimit pyeti lidhur me funksionimin e ekipit për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta duke e vlerësuar këtë si një ide shumë të mirë. Mandej në lëmin e shëndetësisë është mirë që i është dhënë një hapësirë promovimit të shëndetit për ngritjen e edukatës shëndetësore në parandalimin e sëmundjeve ngjitëse seksualisht të transmetueshme siç janë: gonorea, sifilisi Hiv dhe çështja e pengimit të shtatzënisë së padëshirueshme, pastaj kontracepsioni i dukurive negative alkoolizimi, narkomania, prostitucioni, delikuenca ku preventiva do të mund të realizohet përmes ligjëratave dhe flet-palosjeve si mjeteve të shkruara dhe elektronike. Tutje shtoi se në pozicionin mallra dhe shërbime ka mjete të cilat do të mund të përdoren për realizimin e ndonjë projekti për preventiv të dukurive negative nëpër shkolla. Pastaj organizmi i vizitave sistematike është planifikuar dhe ceku se shpreson që këtë vit do të kryhen për klasat e para dhe për parashkollorët. Gjithashtu organizimi i kurseve për emergjencë është mjaft me rëndësi që do të ndikohet pozitivisht për menaxhimin e situatave të ndryshme të ndërlikuara. Në fund inkurajoi të gjithë që të angazhohen për realizimin e këtij plani dhe për përmirësimin dhe kualitetin e jetesës për qytetaret e komunës sonë.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit –paraqiti vërejtje në faqen 36 të planit ku thuhet edukimi i popullatës, vlerësoi se kishte me qenë mirë të përmirësohet termi në *vetëdijësimi i popullatës* kurse, tek faqja 39 ku bëhet fjalë për QPS-në propozoi që të parashihet një pilot-projekt ku kategoria e dytë e asistencës sociale të kalo në zyrën për punësim pasi që qendra duhet të merret me kategorinë e parë e cila është e pa aftë për punë kurse, kategoria e dytë janë persona të cilët mund të punojnë dhe ata do të mund të shfrytëzohen për kryerjen e shërbimeve ndaj komunës si p.sh pastrimin e lumenjve, pastrimin e qytetit dhe punë të tjera që i shërbejnë komunës dhe në këtë formë i shmangemi metodës së krijimit “të parazitëve” por që ato pare që i marrin nga shtetit ti kthejnë me një shërbim dhe kështu të krijojnë shprehi të punës.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit –tha se plani i punës i kryetarit të komunës për vitin 2016 shikuar në aspektin tekstual ka përfshirë shumë pika të sferës së jetës në komunë tonë dhe me interes për qytetaret tanë. Pastaj vlerësoi se është ihtarë që temat e caktuara dhe me peshë të mos shënohen vetëm në letër por ti realizojmë ato premtimi në praktikë. Tutje shtoi se ky plan duhet të bashkërendohet me strategjinë komunale të zhvillimit ekonomik si dhe me kornizën afatmesme buxhetore. Mandej një çështje tjetër që konsideron se duhet ti kushtohet vëmendje është përcjellja e inkasimit të hyrave komunale e që po çalojmë sidomos në arkëtimin e tatimit në pronën e paluajtshme. Në këtë kontekst vlerëson si mjaft me rëndësi hartimin e një plani detal për përcjelljen dhe realizimin e të hyrave vetanake sidomos pas nxjerrjes së ligjit nga ana e Kuvendit të Kosovës për faljen e burgjeve. Gjithashtu çështje tjetër e rëndësishme e që donë angazhim është menaxhimi i pronave komunale si dhe rritjen e të hyrave nga kjo kategori e cila aktualisht është një e hyrë në nivel të ulët. Duke ju referuar prioriteteve vlerësoi se çështje e ujit të pijshëm është zgjatur shumë edhe përkundër premtimeve të vazhdueshme për zgjidhjen e këtij problemi, kurse në planë thuhet se nga vitin 2016 do të kemi ujë 24h kurse muaji janar shkoj dhe akoma nuk kemi realizim të këtij premtimi. Lidhur me projektet ceku se duhet të jemi mjaft të kujdesshëm për faktin që mos të kemi ndërrim të strukturës së projekteve në mënyrë të paligjshëm dhe në të njëjtën kohë të kemi trajtim të barabartë të rajoneve dhe qytetarëve të komunës për orientimin e projekteve. Në fund tha se plani i punës është gjithëpërfshirës dhe apeloj për një angazhim të përgjithshëm për realizimin e tij.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-tha se plani i punës për vitin 2016 është hartuar me kontributin e të gjithëve ku janë involvuar të gjitha drejtoritë komunale me sugjerimet dhe idetë e tyre por se, bazë e hartimit të këtij plani ka qenë planifikimi buxhetor për vitin 2016. Tutje duke ju referuar diskutimeve të anëtarëve të kuvendit ceku se kryetari i komunës në baza periodike ka ofruar raportet të ndryshme për gjendjen e përgjithshme të komunës sonë. Pastaj vlerësoi se komuna ka qenë jashtëzakonisht transparente në shpenzimet komunale duke bërë

raporte financiare para kuvendit dhe kështu ka vepruar gjatë gjithë kohës. Lidhur me aplikimin e prokurimit online njoftoi se për këtë çështje janë duke u trajtuar punëtoret dhe kjo metodë pritet që shumë shpejt të aplikohet. Sa i përket analizave të dheut për kultivimin e pemëve njoftoi se komuna ka një kontratë me kompaninë konsulent IADK dhe ata janë të thirrur për realizimin e këtyre analizave. Pastaj lidhur me idenë që përfituesit e ndihmave të kryejnë punë (shërbime) për komunën ceku se kjo është një ide e mirë por duhet të shikohet ana ligjore e kësaj çështje. Mandej lidhur me zbatimin e strategjisë komunale për zhvillim ekonomik tha se ky dokument është realizuar në masë të madhe por asnjëherë nuk ka vend për vetëkënaqësi. Pastaj kur bëhet fjalë për realizimin e të hyrave kemi përmirësim nga viti i kaluar por jo i planifikuar dhe kjo dihet që planifikim realizohet nga niveli qendrorë e jo nga komuna në këtë relacion njoftoi se ka pasur disa pengesa ndërto ka qenë edhe nxjerrja e ligjit për faljen e borxheve por sido që të jetë kemi ngritje të të hyrave në fushën e urbanizimit dhe nga dhënia e pronës komunale në shfrytëzim. Kurse lidhur me fabrikën e ujit njoftoi se kjo fabrikë është kryer pranim teknik i saj ka përfunduar Ministria e Financave e ka dërguar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik si aset i saj kurse kjo e fundit ia ka dërguar kompanisë rajonale të ujërave në Mitrovicë dhe tani pritet aktivizimi i saj por ekziston një problem që Ministria e Financave nuk ka planifikuar mjete për aktivizimin e kësaj fabrike.

4. Shqyrtimi i Raportit Tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, si dhe realizimin e investimeve kapitale.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit – pyeti se ky raport a është tre mujor apo raport vjetor, për faktin se nga faqja e parë deri tek faqja e fundit thuhet se ky raport është vjetor. Pastaj vlerësoi se raporti ka vetëm tabela ku i mungojnë komentet (sqarim) ku do të ishte mirë që në të ardhmen të kemi sqarime të tilla. Tutje lidhur me shpenzimet e reprezentacionit dhe të telefonave kishte me qenë mirë të jepen sqarime për faktin se kemi tejkalim të shpenzimeve. Mandej nuk është sqaruar si duhet se a është realizuar buxheti i vitit të kaluar dhe prioritetet e vitit 2015. Në relacion të transparencës mund të thuhet se në raport nuk janë përfshirë vërejtje e auditorit të jashtëm dhe kërkoi që çdo pozicion buxhetor në fund të tabelës të sqarohet me shkrim.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se kur merret për bazë ky raport duhet thënë se kemi ndryshim pozitiv krahasuar me tre mujorin paraprak në realizimin e buxhetit për faktin se atëherë kemi pasur një ngecje të madhe sidomos në investimet kapitale dhe realizimin e të hyrave në përgjithësi me këtë shihet se buxheti është realizuar në masën 96% kurse investimet kapitale 95%. Tutje shtoi se si çështje e cila mbetet akoma të angazhohemi është çështja e të hyrave vetanake që kemi ngecje 24% respektivisht realizim 76% prandaj, na mbetet për detyrë të bëjmë një plan konkret për rritjen e të hyrave vetanake. Pastaj ai pyeti për pozicionin ‘‘mirëmbajtje rutinore’’ në vlerën prej 52,810€, mandej kemi rritje të shpenzimeve të energjisë elektrike. Një tjetër çështje jo sa duhet e kuptueshme mirëmbajtje e pajisjeve dhe mobileve në vlerë prej 19,224€, pije jozyrtare 24,000€, kurse vitin paraprak kemi pasur 9,355€, nafta dhe ngrohjet kemi rritje dhe ne dimë se ka kohë që çmimet në treg kanë pësuar rënie por shpenzimet janë rritur dhe kjo duhet të sqarohet se a janë blerë karburantet me çmimet e kontraktuara më herët apo ka pasur ndonjë klauzolë që karburantet të blihen sipas çmimit të tregut, riparimi i veturave është shumë i shtrenjtët 28,000€. Në fund tha se qeveria komunale duhet të ketë për bazë që ti racionalizoj shpenzimet komunale dhe ti rrit kursimet.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së- paraqiti sqarime profesionale lidhur me raportin në fjalë duke dhënë përgjigje në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- tha se kjo është një informatë tre mujore nuk është një raport i detajuar ku do të jepeshin të dhëna se kah janë shkuar mjetet financiare. Lidhur me shpenzimet për mirëmbajtjen e veturave arsyetoj se veturat janë të vjetra dhe shkalla e amortizimit është e lartë andaj edhe shpenzimet është e arsyeshme që të jenë të larta.

5.Shqyrtimi i Planit të Punës së Prokurimit për vitin 2016.

6.Shqyrtimi i Raportit për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollor 2015/2016 dhe përgatitjet për gjysmë vjetorin e dytë.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit-tha se kjo informatë është e hartuar mirë e njëjta është gjithëpërfshirëse dhe se Drejtorja e Arsimit ka arritur ti realizoj prioritetet e saj duke rritur numrin e nxënësve parashkollor. Pastaj shtoi se është bërë një punë e mirë në renovimin e shkollës fillore “Bahri Kuqi” dhe apeloj që të vazhdohet akoma të investohet në këtë shkollë duke realizuar edhe izolimin e ndërtesës shkollore si dhe ndërrimi i dritareve. Tutje shtoi se kur bëhet fjalë për institucionin para fillor “foleja” është bërë një punë shumë e madhe në deratizim dhe furnizim me ushqim. Pastaj ajo kërkoi nga DA-ja që ti silltet menyuja e ushqimit dhe e njëjta të analizohet dhe nëse është e nevojshme të ndryshohet. Në relacion të nxënësve pyeti se çfarë do të bëhet me 16 nxënës të pa notuar në shkollën profesionale “Bahri Haxha”.

Myrvete Hetemi, anëtare e kuvendit –duke ju referuar faqes 3 të informatës në fjalë paraqiti vërejtje e saj lidhur me nxënësit parashkollor duke shtuar se prej 896 sa janë 563 janë të përfshirë të cilët nuk paguajnë kurse 333 fëmijë financohen nga prindërit dhe pyeti se a paraqet kjo një diskriminim ndaj fëmijëve tjerë kur dihet faktin se nëpër këto shkolla të cilat nuk paguajnë janë kryesisht shkolla të qytetit e që edhe kushtet e prindërve janë më të mira, kurse tjerët që paguajnë e kanë gjendjen ekonomike ma të dobët dhe kjo paraqet diskriminim.

Musaj Tërbunja, drejtor i DA-së- paraqiti sqarime lidhur me informatën në fjalë duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

7.Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjetjen e eshtrave në fshatin Duboc.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit –tha se në saje të gjetjes të këtyre eshtrave dëshmohet se edhe në të kaluarën ka pasur luftëra dhe vuajtje nga regjime të ndryshme në trojet tona. Pastaj shtoi se organet kompetente duhet që me metoda shkencore qoftë edhe përmes metodës së ADN-së të vërtetojnë disa gjëra lidhur me këta eshtra të gjetur për atë se prej cilës kohë datojnë këta eshtra dhe mënyrën e ekzekutimit të tyre. Tutje vlerësoi se e habit një fakt se si munden institucionet tona kaq lehtë të thonë se nuk janë përgjegjëse për analizën e këtyre eshtrave për këtë etapë kohore. Andaj në lidhje me këtë temë duhet që organet komunale në mënyrë permanente të ushtrojnë trysni tek institucionet qendrore por edhe tek institutet kompetente profesionale që ta bëjnë verifikimin e saktësisë të atyre kufomave dhe kohen prej kur datojnë në mënyrë që ne por edhe të gjithë qytetaret të kemi një qetësi shpirtërore.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit –tha se në bazë të verifikimit shkencorë është konstatuar se këto kufoma janë nga lufta e dytë botërore. Tutje shtoi se në informatë nuk sqarohet edhe për 16 thasë me eshtra që llogariten diku afër 50 kufoma dhe se nuk dihet se a janë të atij burimi (varri masiv). Pastaj theksoi se metoda e ADN-së nuk është vonë asnjëherë të bëhet dhe vlerësoi se është absurde të thuhet se Instituti i Mjekësisë Ligjore ka autorizim të bëjë verifikimin vetëm për kufomat e luftës së fundit.

Rushit Bilalli, zyrtar i DSHP-së-paraqiti sqarime lidhur me informatën në fjalë duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-tha se qeverisë komunale i takon ti kryej pjesën e punëve që hyjnë në përgjegjësit tona për aq sa kemi kapacitete dhe mundësi. Tutje shtoi se është e dhimbshme që këto kufoma janë gjetur por është më mirë që ato janë gjetur se sa mos të ishin gjetur asnjëherë. Pastaj vlerësoi se në bazë të dhënave që posedojmë nuk mund të konstatojmë formën e ekzekutimit të tyre. Në fund ai u zotua që do të bënë përpjekje që të ndikoj në institucione kompetentet për realizimin e ekzaminimeve për qitjen në dritë të fatit të këtyre kufomave.

Në vazhdim kuvendi i komunës vendosi që bashkërisht ti shqyrtoj pikat e rendit të ditës nga pika 8 deri tek pika 14

8. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës Trungjet e Shpardhit (*Quercus frainetto*) në Zhilivodë të Vushtrrisë si monument i natyrës;

9. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës Trungjet e Dushkut në Druar të Vushtrrisë si monument i natyrës;

10. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës Trungjet e Dushkut (*Quercus sp*) në Galicë të Vushtrrisë si monument i natyrës;

11. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës Trungu i Bungut (*Quercus petraea*) në Shtitaricë të Vushtrrisë si monument i natyrës;

12. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës Trungu i Rrënjës (*Quercus robur*) në Dumnicën e Llugës të Vushtrrisë si monument i natyrës;

13. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës Burimi Terminal në Gjelbishtë të Vushtrrisë si monument i natyrës;

14. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës Trungu i Qarrit (*Quercus cerris*) në Ceceli të Vushtrrisë si monument i natyrës.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit-kërkoi të jepen sqarime se nëse këto vlera të natyrës (drunjtë dhe burimet e ujit) ndodhen në prona private atëherë këta pronar a do të kompensohen apo vetëm këto vlera do të futen në mbrojtje apo se këto prona do të shndërrohen në prona komunale.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit-pyeti se a janë hulumtuar të gjitha vendet pasi që, kësi lloj vlerash të natyrës ka edhe në lokalitetet tjera të komunës sonë andaj kishte me qenë mirë që këto vlera të përfshihen të gjitha.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit –tha se kësi lloj vlerash të natyrës ka edhe në lokalitetet tjera të komunës dhe ceku fshatin Studime e Epërme ku dominon druri i qarrit, bungut dhe shpardhit andaj kërkoi që në të gjitha fshatrat të hulumtohet dhe të njëjtat të futen në mbrojtje.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-pyeti se nëse këto vlera, futen në mbrojtje si do të bëhet ruajtja e tyre a do të bëhet ndonjë rrethoj apo do të vendoset ndonjë tabelë përreth këtyre drunjtëve.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-tha se monumentet kulturore qoftë ato natyrore apo edhe ndërtimet mund të futen në mbrojtje edhe kur gjenden në pronë private. Tutje sqaroi se ato prona mund të shfrytëzohen por nuk mund t’iu ndryshohet gjendja. Mandej ceku se iniciativa për mbrojtjen e këtyre monumenteve është marrë nga Ministria e Mjedisit dhe mund të themi se në komunën tonë kemi edhe vlera tjera monumentale të cilat do të hulumtohen dhe futen në mbrojtje në të ardhmen.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota unanime vendosi me sa vijon:

Aprovohen në pako propozim-vendimet e poshtë-shënuara:

8. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës Trungjet e Shpardhit (*Quercus frainetto*) në Zhilivodë të Vushtrrisë si monument i natyrës;

1. Me këtë vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës Trungjet e shpardhit (*Quercus frainetto*) në fshatin Zhilivodë të Vushtrrisë si monument i natyrës i karakterit botanik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).

Monumenti i Natyrës me hapësirën përfshirëse të projeksonit të kurorës dhe zonës buferike prej 5 m. rreth projeksonit të kurorës, përfshinë sipërfaqen prej 10 ari.

Monumenti i Natyrës ka pamje karakteristike të kurorës, vjetërsi dhe vlera të tjera natyrore dhe si i tillë është i rrallë jo vetëm për territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Lartësia e kërcellit të Monumentit të Natyrës është rreth 15 m gjegjësisht 20 m, perimetri i kërcellit është 2.60 m gjegjësisht 3.70 m, diametri i kurorës rreth 20 m gjegjësisht 25 m dhe vjetërsia është mbi 150 vite.

2. Monumenti i Natyrës gjendet në varrezat e fshatit, në parcelën 632-0, zona kadastrale Zhilivodë, nr. P-70202033-00632-0, me sipërfaqe 12801 m², e regjistruar si varreza, në pronësi publike.
3. Monumenti i Natyrës sipas IUCN - it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III – të, Natural Monument / Natural Landmark – Monument i Natyrës.
4. Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III-të, të mbrojtjes në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:

4.1. Në Monumentin e Natyrës ndalohet:

4.1.1. Prerja e trungjeve, thyerja e degëve, mbledhja e gjethëve apo fryteve, kositja e barit si dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme;

4.1.2. Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur;

4.1.3. Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur;

4.1.4. Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur;

4.1.5. Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur;

4.1.6. Punimi (lëvrimi, shfrytëzimi) i tokës në sipërfaqen e mbrojtur dhe

4.1.7. Aktivitetet të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës.

5. Në Monumentin e Natyrës lejohen:

5.1. Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

6. Në zonën buferike të Monumentit të Natyrës ndalohet:

6.1. Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera;

6.2. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike;

6.3. Ndërrimi i kulturës;

6.4. Mbjella e bimëve ose ngritja e objekteve të cilat mundën me ndikuar në pengimin e pamjes të Monumentit të natyrës.

Zona buferike e Monumentit të Natyrës si dhe hapësira rrethuese mund të rregullohet dhe të shfrytëzohet për qëllime të prezantimit me kusht që destinimet e reja nuk e rrezikojnë Monumentin e Natyrës.

7. Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset Komuna e Vushtrrisë.

7.1. Kujdestari është i detyruar:

7.1.1. Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes;

7.1.2. Në rast të paraqitjes të ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës mundën ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës;

7.1.3. Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit të Natyrës në pajtim me Rregulloren për Shënjimin e Zonave të Mbrojtura.

8. Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomiko-pyjore, hidroekonomike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit të Natyrës.

9. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës Trungjet e Dushkut në Druar të Vushtrrisë si monument i natyrës;

1. Me këtë vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës Trungjet e dushkut në fshatin Druarë të Vushtrrisë si monument i natyrës i karakterit botanik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).

Monumenti i Natyrës me hapësirën përfshirëse të projekcionit të kurorës dhe zonës buferike prej 5 m. rreth projekcionit të kurorës, përfshinë sipërfaqen prej 10 ari.

Monumenti i Natyrës ka pamje karakteristike të kurorës, vjetërsi dhe vlera të tjera natyrore dhe si i tillë është i rrallë jo vetëm për territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Lartësia e kërcellit e Monumentit të Natyrës është rreth 37 m gjegjësisht 27 m, perimetri i kërcellit është 6.10 m gjegjësisht 4.10 m, diametri i kurorës rreth 24 m dhe vjetërsia është 200-300 vite.

2. Monumenti i Natyrës gjendet në varrezat e fshatit, në parcelën 739-0, zona kadastrale Druar, nr. P-70202030-00739-0, me sipërfaqe 4429 m², e regjistruar si varreza, në pronësi publike.

3. Monumenti i Natyrës sipas IUCN - it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III – të, Natural Monument / Natural Landmark – Monument i Natyrës.

4. Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III-të, të mbrojtjes në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:

4.1. Në Monumentin e Natyrës ndalohet:

4.1.1. Prerja e trungjeve, thyerja e degëve, mbledhja e gjetheve apo fryteve, kositja e barit si dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme;

4.1.2. Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur;

4.1.3. Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur;

4.1.4. Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur;

4.1.5. Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur;

4.1.6. Punimi (lëvrimi, shfrytëzimi) i tokës në sipërfaqen e mbrojtur dhe

4.1.7. Aktivitetet të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës.

5. Në Monumentin e Natyrës lejohen:

5.1. Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

6. Në zonën buferike të Monumentit të Natyrës ndalohet:

6.1. Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera;

6.2. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike;

6.3. Ndërrimi i kulturës;

6.4. Mbjellja e bimëve ose ngritja e objekteve të cilat mundën me ndikuar në pengimin e pamjes të Monumentit të natyrës.

10. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës Trungjet e Dushkut (*Quercus sp*) në Galicë të Vushtrrisë si monument i natyrës;

1. Me këtë vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës Kompleksi i trungjeve të dushkut (*Quercus sp.*) në fshatin Galicë të Vushtrrisë si monument i natyrës i karakterit botanik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).

Monumenti i Natyrës me hapësirën përfshirëse të projeksionit të kurorës dhe zonës buferike prej 5 m. rreth projeksionit të kurorës, përfshinë sipërfaqen prej 15 ari.

Monumenti i Natyrës ka pamje karakteristike të kurorës, vjetërsi dhe vlera të tjera natyrore dhe si i tillë është i rrallë jo vetëm për territorin e Komunës së Vushtrrisë.

2. Monumenti i Natyrës gjendet në varrezat e fshatit, në parcelat 390-0 dhe 323-0, zona kadastrale Galicë, nr. P-70215013-00390-0 dhe P-70215013-00390-0, me sipërfaqe 9735 m² dhe 6840 m², e regjistruar si varreza, në pronësi publike.
3. Monumenti i Natyrës sipas IUCN - it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III – të, Natural Monument / Natural Landmark – Monument i Natyrës.
4. Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III-të, të mbrojtjes në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:

4.1. Në Monumentin e Natyrës ndalohe:

4.1.1. Prerja e trungjeve, thyerja e degëve, mbledhja e gjetheve apo fryteve, kositja e barit si dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme;

4.1.2. Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur;

4.1.3. Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur;

4.1.4. Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur;

4.1.5. Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur;

4.1.6. Punimi (lëvrimi, shfrytëzimi) i tokës në sipërfaqen e mbrojtur dhe

4.1.7. Aktivitetet të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës.

5. Në Monumentin e Natyrës lejohen:

5.1. Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

6. Në zonën buferike të Monumentit të Natyrës ndalohe:

6.1. Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera;

6.2. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike;

6.3. Ndërrimi i kulturës;

6.4. Mbjellja e bimëve ose ngritja e objekteve të cilat mund të ndikuar në pengimin e pamjes të Monumentit të natyrës.

Zona buferike e Monumentit të Natyrës si dhe hapësira rrethuese mund të rregullohet dhe të shfrytëzohet për qëllime të prezantimit me kusht që destinimet e reja nuk e rrezikojnë Monumentin e Natyrës.

7. Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset Komuna e Vushtrrisë.

7.1. Kujdestari është i detyruar:

7.1.1. Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes;

7.1.2. Në rast të paraqitjes të ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës mundën ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës;

7.1.3. Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit të Natyrës në pajtim me Rregulloren për Shënjimin e Zonave të Mbrojtura.

8. Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomiko-pyjore, hidroekonomike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit të Natyrës.

11. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës Trungu i Bungut (*Quercus petraea*) në Shtitaricë të Vushtrrisë si monument i natyrës;

1. Me këtë vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës Trungu i bungut (*Quercus petraea*) në fshatin Shtitaricë të Vushtrrisë si monument i natyrës i karakterit botanik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).

Monumenti i Natyrës me hapësirën përfshirëse të projeksonit të kurorës dhe zonës buferike prej 5 m. rreth projeksonit të kurorës, përfshinë sipërfaqen prej 5 ari.

Monumenti i Natyrës ka pamje karakteristike të kurorës, vjetërsi dhe vlera të tjera natyrore dhe si i tillë është i rrallë jo vetëm për territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Lartësia e kërcellit e Monumentit të Natyrës është rreth 35 m, perimetri i kërcellit është rreth 5.60 m, diametri i kurorës rreth 25 m dhe vjetërsia është rreth 500 vite.

2. Monumenti i Natyrës gjendet te varrezat e fshatit, në parcelën 384-0, zona kadastrale Shtitaricë, nr. P-70202071-00384-0, me sipërfaqe 1828 m², e regjistruar si tokë bujqësore, në pronësi private/bashkëposedim (1/6) të: Zarife, Qerim, Selim, Ali, Sinan dhe Haka Mehulli.
3. Monumenti i Natyrës sipas IUCN - it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III – të, Natural Monument / Natural Landmark – Monument i Natyrës.
4. Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III-të, të mbrojtjes në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:

4.1. Në Monumentin e Natyrës ndalohet:

4.1.1. Prerja e trungut, thyerja e degëve, mbledhja e gjetheve apo fryteve, kositja e barit si dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme.

4.1.2. Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur;

4.1.3. Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur;

4.1.4. Ndryshimi i pamjes së sipërfaqes së mbrojtur;

4.1.5. Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur;

4.1.6. Punimi (lëvrimi, shfrytëzimi) i tokës në sipërfaqen e mbrojtur dhe

4.1.7. Aktivitetet të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës.

5. Në Monumentin e Natyrës lejohen:

5.1. Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

6. Në zonën buferike të Monumentit të Natyrës ndalohet:

6.1. Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera;

6.2. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike;

6.3. Ndërrimi i kulturës;

6.4. Mbjella e bimëve ose ngritja e objekteve të cilat mundën me ndikuar në pengimin e pamjes të Monumentit të natyrës.

12. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës Trungu i Rrënjës (*Quercus robur*) në Dumnicën e Llugës të Vushtrrisë si monument i natyrës;

1. Me këtë vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës Trungu i rrënjës (*Quercus robur*) në fshatin Dumnicë e Llugës të Vushtrrisë si monument i natyrës i karakterit botanik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).

Monumenti i Natyrës me hapësirën përfshirëse të projekcionit të kurorës dhe zonës buferike prej 5 m. rreth projekcionit të kurorës, përfshinë sipërfaqen prej 5 ari.

Monumenti i Natyrës ka pamje karakteristike të kurorës, vjetërsi dhe vlera të tjera natyrore dhe si i tillë është i rrallë jo vetëm për territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Lartësia e kërcellit e Monumentit të Natyrës është rreth 15 m, perimetri i kërcellit është rreth 4.30 m, diametri i kurorës rreth 18 m dhe vjetërsia është mbi 300 vite.

2. Monumenti i Natyrës gjendet pranë rrugës kryesore, në parcelën 959-0, zona kadastrale Dumnicë e Llugës, nr. P-70202040-00959-0, me sipërfaqe 18832 m², e regjistruar si tokë bujqësore-arë, në pronësi privat të Hetem dhe Islam Selimi.

3. Monumenti i Natyrës sipas IUCN - it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III – të, Natural Monument / Natural Landmark – Monument i Natyrës.

4. Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III-të, të mbrojtjes në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat

4.1. Në Monumentin e Natyrës ndalohet:

4.1.1. Prerja e trungjeve, thyerja e degëve, mbledhja e gjetheve apo fryteve, kositja e barit si dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme;

- 4.1.2. Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur;
- 4.1.3. Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur;
- 4.1.4. Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur;
- 4.1.5. Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur;
- 4.1.6. Punimi (lëvrimi, shfrytëzimi) i tokës në sipërfaqen e mbrojtur dhe
- 4.1.7. Aktivitetet të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës.

5. Në Monumentin e Natyrës lejohen:

5.1. Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

6. Në zonën buferike të Monumentit të Natyrës ndalohet:

- 6.1. Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera;
- 6.2. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike;
- 6.3. Ndërrimi i kulturës;
- 6.4. Mbjellja e bimëve ose ngritja e objekteve të cilat mund të ndikuar në pengimin e pamjes të Monumentit të natyrës.

Zona buferike e Monumentit të Natyrës si dhe hapësira rrethuese mund të rregullohet dhe të shfrytëzohet për qëllime të prezantimit me kusht që destinimet e reja nuk e rrezikojnë Monumentin e Natyrës.

7. Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset Komuna e Vushtrrisë.

7.1. Kujdestari është i detyruar:

7.1.1. Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes;

7.1.2. Në rast të paraqitjes të ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës mund të shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës;

7.1.3. Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit të Natyrës në pajtim me Rregulloren për Shënjimin e Zonave të Mbrojtura.

Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomiko-pyjore, hidroekonomike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit të Natyrës.

13. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës Burimi Terminal në Gjelbishtë të Vushtrrisë si monument i natyrës;

1. Me këtë vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës **Burimi i ujit termomineral** në fshatin Gjelbishtë të Vushtrrisë si monument i natyrës i karakterit hidrologjik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).

Monumenti i Natyrës me hapësirën përfshirëse dhe zonën buferike prej 5 m., përfshinë sipërfaqen prej **10 ari**.

Monumenti i Natyrës me vlerat e tij natyrore është i rrallë jo vetëm për territorin e Komunës së Vushtrrisë.

2. Monumenti i Natyrës gjendet në vendin e quajtur “Radulov potok/Zejfov breg” në parcelën 27-2, zona kadastrale Gjelbishtë, nr. P-70202061-00027-2, me sipërfaqe 68240 m², e regjistruar si tokë pyjore, në pronësi të Ekonomisë së Pyjeve.
3. Monumenti i Natyrës sipas IUCN - it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III – të, Natural Monument / Natural Landmark – Monument i Natyrës.
4. Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III-të, të mbrojtjes në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:

4.1. Në Monumentin e Natyrës ndalohe:

4.1.1. Ndërhyrja në burim dhe rreth tij;

4.1.2. Çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme të burimit;

4.1.3. Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur;

4.1.4. Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur;

4.1.5. Punimi (lëvrimi, shfrytëzimi) i tokës në sipërfaqen e mbrojtur dhe

4.1.7. Aktivitetet të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës.

5. Në Monumentin e Natyrës lejohen:

5.1. Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

6. Në zonën buferike të Monumentit të Natyrës ndalohe:

6.1. Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera;

6.2. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike;

6.3. Ndërrimi i kulturës;

6.4. Mbjella e bimëve ose ngritja e objekteve të cilat mundën me ndikuar në pengimin e pamjes të Monumentit të natyrës.

Zona buferike e Monumentit të Natyrës si dhe hapësira rrethuese mund të rregullohet dhe të shfrytëzohet për qëllime të prezantimit me kusht që destinimet e reja nuk e rrezikojnë Monumentin e Natyrës.

7. Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset Komuna e Vushtrrisë.

7.1. Kujdestari është i detyruar:

7.1.1. Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes;

7.1.2. Në rast të paraqitjes të ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës mundën ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës;

7.1.3. Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit të Natyrës në pajtim me Rregulloren për Shënjimin e Zonave të Mbrojtura.

8. Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomiko-pyjore, hidroekonomike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit të Natyrës.

14. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës Trungu i Qarrit (*Quercus cerris*) në Ceceli të Vushtrrisë si monument i natyrës.

1. Me këtë vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës Trungu i qarrit (*Quercus cerris*) në fshatin Ceceli të Vushtrrisë si monument i natyrës i karakterit botanik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).

Monumenti i Natyrës me hapësirën përfshirëse të projeksonit të kurorës dhe zonës buferike prej 5 m. rreth projeksonit të kurorës, përfshinë sipërfaqen prej 5 ari.

Monumenti i Natyrës ka pamje karakteristike të kurorës, vjetërsi dhe vlera të tjera natyrore dhe si i tillë është i rrallë, jo vetëm për territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Lartësia e kërcellit e Monumentit të Natyrës është rreth 20 m, perimetri i kërcellit është 3.10 m, diametri i kurorës rreth 17 m dhe vjetërsia është mbi 150 vite.

2. Monumenti i Natyrës gjendet te varrezat e fshatit, në parcelën 1178-0, zona kadastrale Ceceli, nr. P-70202068-01178-0, me sipërfaqe 19172 m², e regjistruar si varreza, në pronësi publike.

3. Monumenti i Natyrës sipas IUCN - it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III – të, Natural Monument / Natural Landmark – Monument i Natyrës.

4. Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III-të, të mbrojtjes në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:

4.1. Në Monumentin e Natyrës ndalohet:

4.1.1. Prerja e trungjeve, thyerja e degëve, mbledhja e gjethëve apo fryteve, kositja e barit si dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme;

4.1.2.Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur;

4.1.3.Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur;

4.1.4.Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur;

4.1.5.Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur;

4.1.6. Punimi (lëvrimi, shfrytëzimi) i tokës në sipërfaqen e mbrojtur dhe

4.1.7.Aktivitetet të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës.

5. Në Monumentin e Natyrës lejohen:

5.1. Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

6. Në zonën buferike të Monumentit të Natyrës ndalohe:

6.1. Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera;

6.2. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike;

6.3. Ndërrimi i kulturës;

6.4. Mbjellja e bimëve ose ngritja e objekteve të cilat mund të ndikuar në pengimin e pamjes të Monumentit të natyrës.

Zona buferike e Monumentit të Natyrës si dhe hapësira rrethuese mund të rregullohet dhe të shfrytëzohet për qëllime të prezantimit me kusht që destinimet e reja nuk e rrezikojnë Monumentin e Natyrës.

7. Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset Komuna e Vushtrrisë.

7.1. Kujdestari është i detyruar:

7.1.1.Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes;

7.1.2.Në rast të paraqitjes të ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës mund të shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës;

7.1.3.Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit të Natyrës në pajtim me Rregulloren për Shënjimin e Zonave të Mbrojtura.

8. Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomiko-pyjore, hidroekonomike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit të Natyrës.

15. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit –tha se pajtohet me opinionin ligjor të zyrës ligjore të komunës lidhur me afatin për dhënien në shfrytëzim të këtyre pronave. Pastaj vlerësoi se duhet të hiqet *pasusi me mundësi vazhdimi* për afatin e dhënës në shfrytëzim. Propozoi që afati i dhënies në shfrytëzim të jetë 5 vite.

Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit-gjithashtu u pajtua me mendimin e zyrës ligjore, ku thuhet se ligjërisht nuk njohin alternativ për kontratë për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale me *mundësi vazhdimi*. Pastaj ai propozoi që afati i dhënies në shfrytëzim i këtyre pronave të jetë 15 vite, për faktin se kjo është e mirë edhe për qiramarrësit sepse ky afat do tu mundësonte kthimin e investimeve.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit –tha se pika 1.6 e propozim-vendimit në fjalë ku thuhet jepja në shfrytëzim e sipërfaqes prej 12m² në oborrin e shkollës fillore në Shtitaricë duhet të hiqet nga ky propozim-vendim, me arsyetimin se asnjë shkollë nuk ka objekte (kioska) të tilla dhe se me këtë po bëhet edhe një ndarje në kuptimin psikologjik pasi në një numër i nxënësve nuk ka mjete për ti blerë ata artikuj ushqimorë. Tutje shtoi se tek pika 2.3 e propozim-vendimit të shtohet edhe një pika 2.4 ku do të thuhej: përfituesit e pronës në shfrytëzim nuk kanë të drejt që këto prona tu japin pronarëve tjerë (nën qira).

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –e mbështeti propozimin që dhënia në shfrytëzim e këtyre pronave të jepet për 15 vite, pasi nga praktika kemi raste që këta shfrytëzues nuk kanë mundur ti kthejnë investimet e bëra kur afati ka qenë më i shkurtër andaj mbështeti zgjatjen e këtij afati.

Idriz Muzaqi, udhëheqës i Zyrës Ligjore-tha se është e drejt e kuvendit përcaktimi i afatit për dhënie në shfrytëzim i këtyre pronave prej 1 deri në 15 vite, dhe sugjeroi që me qenë se afati i planit zhvillimor komunalë është 8 vite atëherë kishte me qenë e arsyeshme që edhe dhënia në shfrytëzim të jetë për këtë afat.

Sami Istrefi, drejtor i DUMM-së- paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës duke u përgjigjur në pyetje e anëtarëve të kuvendit.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit-tha se e mbështet mendimin që në oborret e shkollave të mos ketë kurrfarë objektesh “afariste”, për faktin se nëse e lejojmë në një gjë të tillë në një shkollë atëherë kjo do të paraqitet dhe do të kemi kërkesa që në të gjitha shkollat për ti dhënë këto kioska në shfrytëzim.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit –njoftoi se gjatë mandatit të tij si Drejtor i Drejtorisë së Arsimit nuk ka lejuar që këto objektet të ndërtohen në oborret e shkollave dhe kërkoi që ky propozim të hiqet dhe i njëjti të mos votohet.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit –e mbështeti mendimin që në oborret e shkollave të mos ketë asnjë objekt afaristë kurse lidhur me afatin prej 5 viteve për dhënie në shfrytëzim arsyetoi se ky afat është mesatar dhe i njëjti pas përfundimit mund të vazhdohet duke ju nënshtruar procedurave të ankandit publik.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit –tha se objekte afariste kemi gati afër çdo shkolle dhe ato nuk ka mundësi të ndalojmë që të ushtrojnë veprimtarin e tyre. Në këtë kontekst shtoi se çështja e përkujdesjes ndaj nxënësve lidhet me përgjegjësin dhe punën e drejtorëve të shkollave dhe stafit mësimor. Andaj lidhur me rastin e dhënies në shfrytëzim të lokalit tek shkolla e fshatit Shtitaricë vlerësoi se nuk sheh ndonjë problem nëse ai lokal jepet në shfrytëzim.

Idriz Muzaqi, udhëheqës i Zyrës Ligjore-propozoi që në këtë propozim-vendim të shtohet edhe një pikë me tekstin me sa vijon: në rastet e shkëputjes së njëanshme të kontratës nga komuna, komuna nuk merr kurrfarë përgjegjësie dhe obligimi sa i përket kompensimit të dëmit material dhe fitimit të humbur ndaj qiramarrësit.

Isa Hajrizi, anëtari i kuvendit -tha se komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës së komunës është ndër komisionit më funksionale të kuvendit ndërsa hidhi poshtë çdo mundësi që anëtarët e komisionit të kenë ndonjë konflikt interesi me qiramarrësit.

Sami Istrefi, drejtor i DUMM-së -tha se lokali i cili po jepet në shfrytëzim në fshatin Shtitaricë ndodhet jashtë oborrit të shkollës dhe kjo nuk paraqet ndonjë problem që të jepet në shfrytëzim.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit -tha se në bazë të dokumentacionit që na është prezantuar shihet se ky lokal ndodhet brenda oborrit të shkollës në fshatin Shtitaricë, por vendi se ku ndodhet ai lokal aktualisht nuk ka ankesa por, ne jemi ne dijeni se ky qiramarrës ka kërkuar që ky lokal të futet brenda oborrit të shkollës gjë e cila është e palejueshme dhe priset në këtë formë imazhi i shkollës. Në fund tha se e përkrah propozimin që ky lokal në formën aktuale të jepet në shfrytëzim por jo duke u futur ky lokal brenda oborrit të shkollës.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit -në emër të grupit kuvendar të LDK-së kërkoi informatë me shkrim për të gjitha lokalet emrat e qiramarrësve për objekte që ndodhen tek objekti social.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit, me 22 vota “për”, tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës se paluajtshme te Komunës së Vushtrrisë, e cila gjendet në këto lokacione:

- 1.1. Lokacioni i cili gjendet në ngastrën kadastrale nr.P-70202016-00001-1, Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Komunës e cila përfshinë një sipërfaqe ndërtuese prej 40.88 m², 25.2m², 28.0m², 28.0m², 28.0m², 20.72m², 31.92m² dhe 48.84m² i cili gjendet në rrugën “Tahir Sinani” të marrura nga sipërfaqja e përgjithshme 14732m².
- 1.2. Lokali, i cili gjendet në ngastrën kadastrale nr. P-70202016-00648-0, Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Komunës, i cili përfshin një sipërfaqe ndërtuese prej 32.0 m² i cili gjendet në rrugën “Hasan Prishtina”.
- 1.3. Lokali, i cili gjendet në ngastrën kadastrale nr. P-70202016-02254-2, Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Komunës, i cili përfshin një sipërfaqe ndërtuese prej 11.0 m², i cili gjendet në rrugën “Jeton Tërstena”.
- 1.4. Lokacioni i cili gjendet në ngastrën kadastrale nr.P-70202016-02384-0, Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Komunës, e cila përfshin një sipërfaqe ndërtuese prej 7.0 m² dhe 6.0 m², të cilat gjenden në rrugën “Gjergj Kastrioti Skenderbeu”, të marra nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës prej 17.38 m².
- 1.5. Lokali, i cili gjendet në ngastrën kadastrale nr. P-70202016-1108-19, Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Komunës, e cila përfshin një sipërfaqe ndërtuese prej 8.61 m², 8.61 m², 7.38 m², 9.94 m² dhe 4.0 m², i cili gjendet në Sheshin “Adem Jashari”, të marra nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelën 263.0 m².
- 1.6. Lokali, i cili gjendet në ngastrën kadastrale nr. P-70202016-00270-0, Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Komunës, e cila përfshin një sipërfaqe ndërtuese prej 12.0 m², i cili gjendet në fshatin Shtitaricë, të marra nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës prej 741.0 m².
- 1.7. Lokacioni i cili gjendet në ngastrën kadastrale nr.P-70202016-00520-0, Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Komunës, e cila përfshin një sipërfaqe ndërtuese prej 15.0 m², i cili gjendet në rrugën “Dëshmorët e Kombit”, të marra nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës prej 713.0 m².
- 1.8. Lokacioni i cili gjendet në ngastrën kadastrale nr.P-70202016-00420-2, Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Komunës, e cila përfshin një sipërfaqe ndërtuese prej 15.0 m², i cili gjendet në rrugën “Dëshmorët e Kombit”, të marra nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës prej 340.0 m².

2. Pronat e cekura në pikën 1 të këtij vendimi u jepen në shfrytëzim afatshkurtër përmes ankandit publik personave juridikë dhe fizikë, si objekte të karakterit të përkohshëm (montazh), në kohëzgjatje prej 15 vitesh.
 - 2.1. Çmimi fillestar për m² është 2€ në muaj.
 - 2.2. Të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me lokalit, i bartë përfituesi i ankandit.
 - 2.3. Komuna e Vushtrisë rezervon të drejtën e shpërndarjes së njëanshme të kontratës, nëse një gjë të tillë e parashihet interesi i përgjithshëm. Në këtë rast, Komuna duhet ta njoftojë shfrytëzuesin e objektit së paku 30 ditë para ndërprerjes së kontratës.
 - 2.4. Në rast të shpërndarjes së njëanshme të kontratës, komuna nuk bartë përgjegjësi sa i përket kompensimit të dëmit material dhe fitimit të humbur ndaj qiramarrësit.
 - 2.5. Përfituesit e pronës së paluajtshme komunale përmes ankandit publik, nuk kanë të drejtë të japin në shfrytëzim pronën komunale personave të tretë.
3. Obligohet Komisioni për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale të zhvillojë procedurat për shpalljen e ankandit si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimit të të gjitha kontratave, pas lidhjes së tyre.
4. Pjesë e këtij vendimi janë: certifikata për të drejtën e pronësisë si dhe skicat me të cilat janë të paraqitura objektet e planifikuara (montazhë).

16. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 24 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohet ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore në parcelën kadastrale: nr.P-70202019-00130-0, me kulturë arë e klasës së 5 (pesë), në sipërfaqe prej 700m² të marrë nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës që është 19014m² Zona Kadastrale Dumnicë e Epërme, pronë e Naser (Shahin) Imeri me vendbanim në rrugën “Dëshmorët e Kombit” në Vushtri.
2. Në parcelën kadastrale të cekur si në pikën 1 të këtij vendimi lejohet ndërtimi i objektit ekonomik (Depo për ruajtjen dhe kultivimin e bletëve).
3. Lejen ndërtimore dhe kushtet për rregullimin e hapësirë për ndërtimin e objektit nga pika 2 e këtij Vendimi do ta lëshojë dhe përcaktojë konform dispozitave ligjore Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit pas pagesës së tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore.
4. Obligohet pronari i parcelës nga pika 1 e këtij Vendimi që të bëjë pagesën e tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore sipas nenit 14.2 nën “b” të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore Nr.41/2006, përmes Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

17. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale personave juridik (OJQ) dhe personave fizik (shqyrtimi i dytë).

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit –tha se tek neni 9 pika 2 i kësaj draft-rregulloreje ku flitet për subvencionimin e personave fizik dhe për kriteret që duhet përmbushur një subjekt juridike për të përfituar ndihmë për trajtim shëndetësorë duhet që ky nenë të hiqet për faktin se kjo shkakton përzjerje të kompetencave mes kuvendit të komunës dhe ekzekutivit komunal.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –duke ju referua opinionit ligjor të zyrës ligjore, paraqiti sqarime lidhur me nenin 4 paragrafit 5 të kësaj draft-rregulloreje ku thuhet: Drejtorja e Shëndetësisë shqyrton kërkesat e personave fizik dhe juridik në vlerë mbi 800€ i përcjellë për informim KPF-së dhe nga zyra ligjore është kërkuar të hiqet ky paragraf me të drejt. Kurse në paragrafin 4 thuhet që kryetari i komunës i propozon kuvendit për aprovim kërkesën e personit juridik në rast se kërkesa është më e lartë se 800€. Lidhur me këtë shtoi se qytetarët paraqesin kërkesa të ndryshme sa i përket subvencionimit për shërim dhe çështje të banimit. Tutje shtoi se limiti deri në 800€ për kryetarin e komunës duhet të hiqet dhe kjo shumë të jetë e pa limituar dhe kjo të mbetet në kompetencë të tij pasi të merret edhe propozimi i komisionit të formuar nga ekzekutivi komunal.

Abdullah Klinaku, drejtor i DSHPS-së-paraqiti sqarime lidhur me dokumentin në fjalë duke shtuar se nëse vendoset që të hiqet limit për ndarje të mjeteve nga ana e kryetarit të komunës atëherë kjo rregullore pëson shumë ndryshime.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –propozoi që kjo draft-rregullore të përmirësohet dhe e njëjta të vjen për aprovim në ndonjërin nga mbledhjet e kuvendit.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 20 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

Shtyhet për njërin nga mbledhjet e kuvendit Draft-Rregullorja për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale personave juridik (OJQ) dhe personave fizik më propozimet e dhëna më lart nga ana e anëtarëve të kuvendit.

18.Shqyrtimi i Draft-Rregullores për mbrojtjen e të miturve nga dukuritë që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre (shqyrtimi i dytë).

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota unanime vendosi me sa vijon:

Aprovohet Rregullorja për mbrojtjen e të miturve nga dukuritë që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre.

19.Të ndryshme.

a). Pyetet e anëtarëve të kuvendit.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit- tha se sa i përket grevës së mbajtur para disa ditëve nga komuna e Vushtrrisë, neve na intereson se mbi çfarë baze e keni marr vendimin për pezullimin e jetës institucionale komunale? Sepse dihet qe faji për këtë situatë nuk është ne Vushtrri por te pushteti qendrorë Ne pa dyshim qe jemi për dhënien e tretmanit mjekësor çdo te arrestuari dhe dënuari, pasi që këtë ia garanton edhe ligji gjithashtu, e kemi mbrojtur vazhdimisht luftën Çlirimtare të UÇK-së, duke u solidarizuar e marre pjese ne protestat për mbrojtjen e vlerave te luftës, kemi kundërshtuar edhe formimin e gjykatës speciale e cila tenton te e njollose U.Ç.K-ne. Por, edhe një here po e potencoj qe problemi nuk është ne Vushtrri dhe nuk zgjidhet ne Vushtrri, problemin kërkojeni ne Prishtine te Hashim Thaçi e Isa Mustafa. Pra, mos e dëmtoni qytetarin e Vushtrrisë duke mos i ofruar shërbime, pasi qe fajtoret nuk janë këtu.

Agron Perçuku, anëtar i kuvendit –kërkoj informatë me shkrim nga Drejtoria e Ekonomisë lidhur me subvencionimin e lopëve, pasi që thuhet që ka pasur mjaft parregullsi në këtë projekt.
Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit – në emër të grupit kuvendar të LDK-së kërkoj informatë me shkrim për të gjitha lokalet emrat e qiramarrësve për objekte pronë e komunës që janë dhënë në shfrytëzim.


Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit –tha se komisioni i formuar për verifikimin e projektit për subvencionimin me lopë ka shikuar dokumentacionin dhe nuk ka vërejtur parregullsi, kurse për gjëra tjera nuk ka pasur autorizime.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit-paraqiti vërejtje dhe kritika për krerët komunal për mos dërgimin e ftesave për anëtarët e kuvendit për ngjarjet kulturore dhe aktivitete tjera q shënohen në qytetin e Vushtrrisë.

Arta Haxhaj, drejtoreshë e Drejtorisë për Ekonomi-paraqiti sqarime lidhur me projektin për subvencionimin me lopë qumështore në Komunën e Vushtrrisë, dhe u përgjigj në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:20.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Shpëtim Zhegrova



Kryesues i Kuvendit